



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 468/6 Prot.

Tiranë, më 29.07. 2016

V E N D I M
Nr. 98, datë 29.07.2016

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 468/3 prot., dt. 17.07.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", lejuar nga neni 185 i ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Bashkinë Krujë, për rastin e nëpunësit *****,

VËREJ SE :

Mbi bazën e informacionit të përcjellë nga punonjësi *****, rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 468 prot., datë 01.07.2015, Komisioneri ka nxjerrë urdhrin e verifikimit, nr. 468/3 prot, të datës 17.07.2016, për të kryer veprime të mëtijshme për të sqaruar problemin e ngritur në këtë rast, i cili ka të bëjë me parregullsi gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në zbatim të këtij akti, u krye hetimi i plotë administrativ, u administrua dokumentacioni i nevojshëm për trajtimin e plotë të rastit dhe më pas u vlerësua ligjshmëria e veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për shkak ristrukturimi, të punonjësit ***** , në pozicionin e punës "Inspektor i Tatim Taksave", në Njësinë Administrative Nikël, Bashkia Krujë.

Nga analiza e akteve të administruara rezulton se, punonjësi ***** ka filluar punë me aktin e emërimit nr. 04, datë 24.01.2013, në pozicionin e punës "Inspektor i Tatim Taksave", në Komunën Nikël.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), e ka gjetur këtë punonjës në pozicionin "Inspektor i Tatim Taksave" e për këtë shkak, me të drejtë, me aktin nr. 1141 prot., dt. 03.10.2014, është deklaruar "nëpunës civil", nga ana e njësisë përgjegjëse, në këtë pozicion.

Bazuar në ligjin nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”* dhe atij nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, rezulton se, me Vendimin nr. 71, datë 15.09.2015, Kryetari i Bashkisë Krujë ka miratuar strukturën tranzitore të administratës së bashkisë dhe njërive administrative.

Sipas kësaj strukture, Njësia Administrative Nikël, ka pësuar shkurtim real të numrit të përgjithshëm të vendeve të punës. Konkretisht, nga **17** pozicione pune në shërbimin civil që kishte struktura e mëparshme, ka kaluar vetëm me **10** pozicione të tilla.

Bazuar në këtë ndryshim të strukturës, Kryetari i Bashkisë Krujë, duke bërë një zbatim formal të pikës 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil” (i ndryshuar)*, ka njoftuar punonjësin ***** për përfshirjen në këtë proces, me shkresën nr. 1951/1 prot, datë, 28.09.2015, duke i komunikuar faktin që, për shkak të shkurtimit të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës në shërbimin civil, marrëdhënia e punës me Bashkinë e Krujës do t'i ndërpritet 1 muaj pas daljes së këtij njoftimi. Më pas, me kalimin e këtij afati, Kryetari i Bashkisë, me aktin nr. 116, datë 20.10.2015, *“Për lirim nga shërbimi civil”*, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës për këtë punonjës.

Por nga ana tjetër, duke analizuar veprimet që ka kryer njësia përgjegjëse, të materializuar me aktet përkatëse, konstatohet se procedura e kryer për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për rastin e këtij nëpunësi, nuk është në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në Kreun II dhe III, të Vendimit nr. 171 dt. 26.3.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.

Në këtë rast, në zbatim të pikës 3, të dispozitës së përmendur më sipër, duhet të, ngrihej Komisioni i Ristrukturimit, i cili do të shqyrtonte mundësitë e sistemimit, për secilin prej nëpunësve civilë, në vendet e lira të mbetura apo riorganizuar, pas miratimit të strukturës së re dhe më pas do të bënte propozimet përkatëse për njësinë përgjegjëse (njësinë e burimeve njerëzore) për transferimin e nëpunësit, në ato vende pune, ku ai plotëson kërkesat specifike.

Kjo veprimtari duhet të materializohet në aktet e mëposhtme:

- Urdhri për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit;
- Relacioni përkatës që materializon mënyrën e funksionimit të këtij komisioni dhe propozimet e tij në lidhje me transferimet, riemërimet dhe lirimet nga shërbimi civil, të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar apo ristrukturuar pozicioni i punës;
- Vendimmarrja përfundimtare nga njësia përgjegjëse, për miratimin apo mosmiratimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, si dhe akte të tjera që plotësojnë respektimin e procedurës ligjore në këtë rast.

Pas krijimit dhe fillimit të funksionimit, Komisioni i Ristrukturimit, duke u bazuar në rregullin e përcaktuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; në Vendimin nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimin nr. 3, datë 14.04.2014, të DAP, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*, si për punonjësin në fjalë, ashtu dhe për raste të tjera të ngjashme, duhet të vlerësohet ndërmjet të tjerave, nëse ekzistonte

mundësia për risistemimin e tij në pozicionin e mëparshëm (*pasi konstatohet që nga krahasimi i strukturave, pozicioni "Inspektor i Tatim Taksave", ku ishte i punësuar nëpunësi ******, në momentin e ristrukturimit, nuk është shkurtuar, por vazhdon të ekzistojë) ç'ka realizohet nëpërmjetë krahasimit të përshkrimit të punës për pozicionet para dhe pas ristrukturimit, apo sistemimin e tij në ndonjë pozicion tjetër të mbetur/ristrukturuar, ku ai përmbushte kriteret e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme për vendin e punës.

Vetëm nëse, në përfundim të këtij procesi, nuk do të gjendej asnjë mundësi për sistemimin e tij, me vendim të arsyetuar, Komisioni i Ristrukturimit duhej të paraqiste propozimin përpara njësisë përgjegjëse, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, mbi bazën e të cilit ajo, do të nxirrte aktin për përfundimin e kësaj marrëdhënie dhe lirim nga shërbimi civil.

Ky akt duhet nxjerrë duke respektuar rregullat dhe procedurën e parashikuar nga pikat 7 dhe 8 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, kreu III *"Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit"*, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave *"Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil"* dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, të DAP *"Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit"*.

Nisur nga analiza e mësipërme, arrihet në përfundimin se, akti administrativ nr. 116 prot., datë 20.10.2015, i Kryetarit të Bashkisë Krujë, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të nëpunësit ***** për shkak të ristrukturimit, në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1 të ligjit nr. 8485 dt. 12.05.1999 *"Kodi i Procedurave Administrative të RSH"* (të cilat lejohen të veprojnë, edhe aktualisht, prej nenit 185, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të RSH"*) është një akt absolutisht i pavlefshëm, pasi ka dalë në kundërshtim me formën dhe rregullat e parashikuara prej nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, kreu III *"Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit"*, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave *"Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil"* dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, të D.A.P *"Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit"*.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar; nenet 115, pika "a", 116 pika "c" dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, *"Kodi i Procedurave Administrative në R.SH"*; nenin 35 të Rregullores *"Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil",

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë në administrimin në shërbimin civil, duke filluar me revokimin e aktit administrativ të Kryetarit të Bashkisë Krujë, nr. 116 prot., datë 20.10.2015, *"Për lirim nga shërbimin civil"*, për punonjësin *****.

2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të zbatojë procedurën e përcaktuar në nenin 50, pika 3, e vijues, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 171, dt. 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, për ta sistemuar punonjësin në një pozicion pune, duke respektuar radhën e mëposhtme të veprimeve:
 - Të nxjerë urdhrin për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit;
 - Të monitorojë mënyrën e funksionimit të këtij komisioni dhe hartimin e dokumentacionit e propozimeve që do të përpilohen prej tij, në lidhje me transferimet, riemërimet dhe lirimet nga shërbimi civil, të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar apo ristrukturuar pozicioni i punës;
 - Njësia përgjegjëse të nxjerrë aktet përfundimtare nominale për miratimin apo mosmiratimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, duke pasur parasysh respektimin e të drejtave të nëpunësve civil që lirohen nga shërbimi civil.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që në rastin e pamundësisë për sistemimin e punonjësit/punonjësve të cilëve iu është shkurtuar ose ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke treguar kujdes për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin prej pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, apo të emërohet në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.
4. Bashkia Krujë, të zbatojë vendimin brenda **15** ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për zbatimin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Krujë dhe kërkuesi *****.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA